



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01. Nr.88
Data: 30.09.2025**

Bazuar në nenin 12, paragrafin 12.2 pika d, nenit 40, paragrafi 40.2 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L- 040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 61, paragrafi 61.2 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Neni 25, paragrafi 2 pika 2.2 dhe nenit 45, paragrafi 1.2 dhe 3 të , Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, dhe në bazë të Qarkoreve Buxhetore 2026-01 dhe 2026-02 nga MFPT, Kuvendi i Komunës të Ferizajt, në seancën e mbajtur me datë: 30.09.2025 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2026 DHE
VLERËSIMET E HERSHME BUXHETORE 2027-2028**

I

Me këtë vendim miratohet Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2026 dhe vlerësimet e hershme buxhetore 2027-2028

II

Shuma e buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2026 i cekur në pikën I të këtij vendimi është
53,068,494.00€ dhe atë në kategori ekonomike si më poshtë:

Kategoritë buxhetore	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
1. Paga dhe shtesa	23,623,853.00 €	23,741,972.00 €	23,860,682.00 €
2. Mallra dhe shërbime	11,519,945.00 €	11,923,806.00 €	12,359,367.00 €
3. Shpenzimet komunale	1,010,982.00 €	1,092,159.00 €	1,121,677.00 €
4. Subvencione	2,500,000.00 €	2,815,576.00 €	3,016,688.00 €
5. Shpenzimet kapitale	14,413,714.00 €	16,443,632.00 €	18,300,556.00 €
TOTALI:	53,068,494.00€	56,017,145.00 €	58,658,970.00 €

III

Pjesë përbërse e këtij vendimi është Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2026 dhe vlerësimet e hershme buxhetore 2027-2028 në kuadër të të cilit është edhe tabela e përgjithshme e shpërndarjes së buxhetit

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesues i Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Datede / Iz azne: Date / Dana. 01 / 10 / 2025
Nr. Orgje / Org. jec. 01 Nr. Prot. / Br. Prot. 89 Nr. Faqeve. / Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.89
Data: 30.09.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2025 nxjerr këtë:

VENDIM

PËR PEZULLIMIN E VENDIMIT ME NR.01.41 I DATËS 30.04.2025

I

PEZULLOHET: Vendimi me Nr.01.41 i datës 30.09.2025, përmes së cilit janë shpallur interes i përgjithshëm pjesët e ngastrave kadastrale 777-15 dhe 777-6 Z.K.Dremjak prona private me qëllim të këmbimit me pjesët e ngastrave kadastrale 7736-0 Z.K.Dremjak, pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Ky vendim pezullohet deri në krijimin e kushteve ligjore për procesim tutje të procedurave të këmbimit ashtu si e parasheh Ligji Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër si dhe Kuvendi i Komunës Ferizaj.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

